

Klauzola e pëlqimit paraprak (Kompania)

Unë, i nënshkruari, [_____ emri / _____ mbiemri i deklaruesit], në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të kompanisë [_____] deklaroj dhe garantoj me vullnetin tim të plotë dhe të lirë se informacioni i dhënë nga unë, është i vërtetë, i saktë dhe i plotë.

Duke kuptuar se, të dhëna demografike dhe financiare të kompanisë të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë, do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, sekretin bankar si dhe sekretin profesional, si dhe për faktin se IuteCredit Albania Sh.a. dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjithat masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të mia:

I jap pëlqimin tim të plotë, të lirë IuteCredit Albania Sh.a. që, për qëllimet që përfshijnë:

1. Vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi në emër të kompanisë që jam përfaqësues ligjor;
2. Vlerësimin e rrezikut të kredisë përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies së kredisë me IuteCredit Albania Sh.a.;
3. Vlerësimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësin;

të njihet me detyrimet e kompanisë që përfaqësoj ndaj institucioneve financiare kredidhënëse, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënave të Regjistrin të Kredive, për të vlerësuar vlerën e ekspozimit kreditor në sistemin bankar e financiar, garancitë dhe besueshmërinë/afësinë për të shlyer detyrimet financiare.

Gjithashtu, jap pëlqimin tim që IuteCredit Albania Sh.a. të përdorë emrin dhe të dhënat identifikuese dhe financiare të kompanisë, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

Unë jam informuar siç duhet për të drejtën time si përfaqësues ligjor për të kërkuar informacion mbi të dhënat e kompanisë gjatë periudhës së mbajtjes së tyre nga IuteCredit Albania Sh.a. *si dhe korrigjimin/rishikimin në raste kur ato janë të pasakta, të paplota.* Për një qëllim të tillë, unë jam i vetëdijshëm që çdo kërkesë për sa më sipër mund t'ia drejtoj IuteCredit Albania Sh.a. si më poshtë:

• Në vëmendjen e *Personi i kontaktit të institucionit financiar në të cilin mund të adresohen pretendimet mbi të dhënat e raportuara;*

- Adresa: Rruga “Andon Zako Cajupi”, Pallati Nr. 3, Hyrja Nr. 2, Kati 3, Tiranë, Shqipëri;
- E-mail: info@iute.al;
- Telefon: 044 50 5060;
- www.iute.al.

Unë kam lexuar dhe kuptuar me kujdes përmbajtjen e kësaj Klauzole të Pëlqimit Paraprak dhe njoh pasojat përkatëse ligjore në lidhje me përpunimin e të dhënave të mia personale, informacionit financiar dhe/ose çdo informacioni tjetër në lidhje me veten time në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të huamarrësit dhe, për këtë arsye unë e nënshkruaj këtë dokument me vullnetin tim të plotë dhe të lirë:

☐ **Pranoj**

☐ **Nuk Pranoj**

DEKLARUESI

[qytet]:-----

[datë (dd.mm.vvvv)]:-----

[emri] [mbiemri] : [nënshkrimi] :-----

